



REPUBLICA E KOSOVËS	REPUBLICA KOSOVO
KOMUNA VUSHTRI	OPSTINA VUCITRN
01 Nr / Br	07/19
Nr. i fq. / Br. si	- 8 -
Datu / Datum	17.01.2019



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRI  
OPSTINA VUCITRN

### PROCESVERBAL

nga mbledhja e -XI-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më  
13 dhjetor 2018 në sallën e komunës, e cila filloj në ora 9:20.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Shpëtim Zhegrova, Melihate Basholli-Latiši, Fjolla Ujkani, Ymer Haradinaj, Rrezarta Krasniqi, Shkëlzen Feka dhe Nezir Klinaku (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Lutfi Bilalli.

Gjithashu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Xhafer Tahiri (kryetar i komunës), drejtorët e drejtorive (Sylejman Mehollı, Sedat Rashica, Afrim Namani, Mehmet Selaci), Albanez Tahiraj, nga zyra ligjore, si dhe nga sekretaria e kuvendit, Haki Maloku, Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaltueshme për punë. Ai kërkoi që të futet në rend të dites < Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë financiare për shërim të Bahrije Pllanës >.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – i njoftoi të pranishmit se në këtë seancë të kuvendit të komunës do ta sjellim një propozim-vendim për anulim të konkluzionit të kuvendit të komunës të vitit 1984 për dhënien në shsrytëzim të përhershëm të pronës së paluajtshme të komunës, Drejtorisë së Burgjeve. Ai tha se në vitin 2016, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë me vendim i ka shpallur këto zona me interes të përgjithshëm për qëllim të zhvillimit ekonomik. Ai vendimi nuk është kundërshtuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe as nga Ministria e Drejtësisë. Pastaj tha se tani është koha që të ndërmerrët hapi i dytë dhe përfundimtar që këto prona të kthehen në pronësi të komunës. Në vendimin e vitit 1984 thuhet që pronat do të regjistrohen në emër të Drejtorisë së Burgjeve, kurse në atë kohë është bërë një gabim dhe janë regjistruar si prona të tyre. Ato prona nuk iu kanë falur Drejtorisë së Burgjeve, por u janë dhënë në shsrytëzim të përhershëm. Sipas tij, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve e dallon faljen dhe dhënien në shsrytëzim të përhershëm. Po të ishte falje (dhurim), atëherë ndoshta nuk do të mund t'i kthenim këto prona, sepse ky ligj thotë që dhuratën nuk mund ta kthesht prapa. Mandej tha se kanë biseduar me zyrtarë të MAPL-së, por do të bisedojmë edhe me Qeverinë e Kosovës për çështjen e këtyre pronave, që siç tha ai në atë zonë është krijuar një deponi e madhe e mbeturinave, të cilën as ne e as Ministria e Drejtësisë nuk i menaxhon ato prona. Tahiri theksoi se zyrtarisht kemi një investitor gjerman për këto prona, i cili ka aplikuar në KIESA (Ministri të Tregtisë dhe Industrisë) për statusin e investitorit strategjik, ku parashikohet që të investohen mbi 30 milionë euro në kodrën e Banjskës. Në mund tha se është i gatshëm që të shkojë edhe në gjykatë nëse MAPL-ja do ta anulonte vendimin, nëse kuvendi i komunës e merr për kthim të pronave në pronësi të komunës. MAPL-ja ka të drejtë ta anulojë një vendim për shkaqe procedurale, por nuk ka të drejtë ta anulojë një vendim të kuvendit të komunës për shkaqe

përbajtësore. Prandaj, ai bëri apel që ky vendim të votohet në kuvend të komunës pa dallim partie, sepse është për interes të përgjithshëm.

**Shpëtim Zhegrova**, anëtar i KPF-së – tha se edhe në mandatin e kaluar kemi provuar që ta rikthejmë atë pronë. Ndoshfa, një gjë e tillë është e pamundshme për shkak të gabimit që atëherë është bërë nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër. Sikur të figuronte si shfrytëzues Ministria e Drejtësisë në fletën poseduese në kadastër, do të ishte më lehtë për kuvendin e komunës, pavarsisht asaj që duhet marrë pëlqimin nga ministria. Por, në fletë poseduese figuron si pronar Ministria e Drejtësisë dhe një gjë e tillë është shumë e vështirë të bëhet. Ai tha se ne do të veprojmë unik për një gjë të tillë, pasi që është në interes të të gjithëve, por unë prapë dyshoj se do ta pranojë ministria një gjë të tillë, sepse në të kaluarën është kthyer negativisht. Zhegrova tha se në mandatin e kaluar kam kërkuar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ta përmirësojë këtë gabim, pasi që kjo drejtori duhet ta bëjë përmirësimin, e jo kuvendi. Nëse kjo drejtori e ka guximin mund ta përmirësojë këtë, sepse në mandatin e kaluar nuk e kanë pasur këtë guxim.

**Nezir Klinaku**, anëtar i KPF-së – kërkoi që zyra ligjore paraprakisht të japë një opinion lidhur me këtë çështje.

**Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:**

#### R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 15.11.2018;
  2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen sociale të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë;
  3. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Administratën;
  4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për eaktim të lokacionit për mbeturinat inerte;
  5. Shqyrtimi i Raportit për implementimin e planit për integritet për 2016-2018;
  6. Shqyrtimi i Raportit vjetor 2017 i Ndërmarrjes regionale "Mitrovica";
  7. Shqyrtimi i Raportit vjetor 2017 i Ndërmarrjes "Uniteti";
  8. Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë financiare për shërim të Bahrije Pllanës;
  9. Të ndryshme.
- 
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 15.11.2018.

*Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri me ndryshime aprovoi procesverbalin e datës 15.11.2018.*

2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen sociale të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

**Fjolla Ujkani**, anëtare e KPF-së – tha se viktimat e trafikimit dhe tentimit të dhunimit janë çështje të ndjeshme. Në raport e pash që është vetëm një rast i tentim-dhunimit të një femre të mirur, një rast e shfrytëzimit të një të miture për pornografi, dy raste të abuzimit seksual. Ajo pyeti se kush merret direkt me këto raste? Cilat janë sanksionet ndaj kryerjes së këtyre veprave? Çka mundemi ne si kuvend të ndërmarrim lidhur me këtë çështje?

Ajo kërkoi që kjo çështje të ngritet në instancea më të larta dhe të organizohen fushata sensibilizuese apo ligjërata lidhur me vetëdijesimin seksual nëpër shkolla. Ajo tha se këtë informatë e sheh si jorelevante, sa i përket dhunimeve, pasi konsideroj që ka raste më shumë.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – deklroi se informata është në nivelin e duhur. Ai përmendi një rast që i përket kategorisë së lëmijëve me sjellje të çrregulluara. Pra, fjalë është për djalin e Gani Qerimit që jetojnë në rrugën “Lumni Surdulli”, ku kjo familje është në gjendje të keqe nga sjelljet dhe problemet që i ka shkaktuar djali i tyre, që siç deklroi Klinaku ka mundësi që e ka kaluar edhe moshën e mitur. Prandaj, do të ishte mirë që organet përgjegjëse të merren me këtë rast.

**Sylejman Mehollı, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale** – tha se nuk po them që mund të jetë vetëm një rast i tentim-dhunimit të të miturës, por ka mundësi që ka edhe raste tjera. Mirëpo, ky është rasti i vetëm që është raportuar, kurse Qendra për Punë Sociale (QPS) asiston në të gjitha rastet që lajmërohen në polici dhe në gjykatë. Ai tha se kemi bashkëpunim me organizatat: “Diakonie” dhe “Raba Voca” në Mitrovicë për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, dhunimeve etj., ndërkaq, lidhur me vetëdijesimin, Mehollı tha se kjo është një çështje shumëdimensionale që përveç drejtorisë sonë duhet të përfshihet edhe Drejtoria për Arsim dhe pse jo edhe kuvendi i komunës në ndonjë seancë t'ua kushtojë këtyre rasteve. Kështu që, lidhur me rastin që e përmendi Neziri, ai tha se do të interesohet për këtë rast. Nëse personi në fjalë ka kaluar moshën 18 vjeçare, ai tha se e vëtmja mundësi është të bëhet kërkesë në shërbimin rezidencial në Lumadh, nëse ka vend për strehim. Ndoshta do të ishte mirë (kjo është një ide e imja) që në të ardhmen ndonjë qendër e mjekësisë familjare që ka numër më të vogël të pacientëve, apo edhe në rastet kur janë ndërtuar dy shkolla në një oborr, të bëhet ndarje fizike dhe të bëhet si institucion që merret me trajtimin e këtyre rasteve.

**Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së** – tha se në këtë informatë nuk po ceket periudha e raportimit. Ajo tha se shifrat e raportuara të dhunës në familje janë shumë të vogla krahasuar me realitetin. Prandaj, si shqetësuese e sheh mosraportimin e rasteve. Ajo përmendi edhe rastet asociale në shkolla të mesme, që siç u deklarua, policia vjen dhe merret me këto raste. Prandaj, vetëm këto raste është dashur të raportohen.

**Sylejman Mehollı, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale** – lidhur me mosraportimin e rasteve, ai tha se shumë raste i hesht edhe policia. Ndërkaq, për rastet asociale, ai tha se vet shkolla duhet t'i lajmërojë këto raste.

**Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së** – deklroi se është shqetësuese edhe numri i madh i qytetarëve që lirohen nga shtetësia e Kosovës, ku në këtë informatë është cekur se 291 persona kanë marrë vërtetim në QPS. Ai tha se është një informatë mirë e përgatitur. Aliu kërkoi që në këtë informatë të paraqiten edhe rastet me gjendje të vështirë të banimit.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – theksoi se do të kisha dëshirë që gjendja reale të jetë kështu siç është në këtë informatë, mirëpo kjo nuk varet nga drejtoria, por nga rastet që nuk evidentohen. Ai tha se drejtoria, por edhe komuna në projektin e saj strategjik duhet ta planifikojë caktimin e lokacionit për ndërtimin e një shtëpie për pleq.

**Sylejman Mehollı, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale** – tha se shërbimet sociale nuk mund t'i ndryshojë komuna. Ai tha se shtëpia për pleq mund të ndërtohet, por problem është funksionalizimi i saj (staf, buxheti).

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.*

### 3. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Administratë.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – tha se është një informatë e mirë. Sa iu përket shkresave, ai kërkoi që të përdoret një standard i njëjtë, e jo të ketë laramani. Psh, tek kjo informatë, në faqen e parë, logoja është në dy gjuhë, kurse në faqen e dytë logon e kemi vetëm në gjuhën shqipe. Klinaku kërkoi sqarime sa i përket regjistrimit të vdekjeve. Sipas tij, gjatë periudhës janar-dhjetor sipas kësaj informate janë regjistruar 313 vdekje, kurse, në shtator na është sjellë informata se komuna ka bërë pagesën për më tepër se 350 të vdekur. Prandaj, sipas kësaj kemi një mospërputhje te të dhënat për të vdekurit, i cili shtoi se kjo po i bie që Bashkësia Islame në Vushtrri i paska "varrosur" njerëzit e gjallë. Po ashtu, Bashkësia Islame po e shkel Ligjin për Gjendjen Civile, sepse i varros qytetarët pa e marrë lejen në komunë, tha Klinaku. Në fund pyeti. A keni informacione se kjo shifër prej 313 të të vdekurve, a i përkasin të gjithë besimit islam?

**Mehmet Selaci, drejtor i Drejtorisë për Administratë** – tha se kjo shifër prej 313 të të vdekurve ka të bëjë me regjistrimet e vdekjeve që është bërë në gjendjen civile këtu në komunë. Mirëpo, mund të ketë raste që familjarët nuk e kanë bërë fare regjistrimin e vdekjeve tek ne. Po ashtu, ka qytetarë të Vushtrrisë që kanë vdekur në Prishtinë dhe sipas ligjit regjistrimi i vdekjes bëhet në Prishtinë, kurse është varrosur në Vushtrri. Prandaj, kjo është arsyaja që ka mospërputhje të shifrave. Edhe Selaci tha se Bashkësia Islame i varros qytetarët pa e marrë lejen në komunë, që sipas ligjit duhet ta merr lejen, i cili shtoi se kjo shkelje po bëhet në krejt Kosovën. Ai tha se ka pasur takim me përfaqësues të Bashkësisë Islame në Vushtrri dhe ka kërkuar prej tyre që brenda mundësive të na e dërgojnë regjistrin e vdekjeve çdo 15 ditë për vdekjet që kanë ndodhur në territorin e komunës sonë, në mënyrë që t'i njoftojmë familjarët për regjistrim të vdekjeve, ku në këtë rast i kanë në dispozicion 15 ditë. Pra, sipas ligjit, familjarët janë të obliguar që ta bëjnë regjistrimin e vdekjes në afat prej 30 ditësh, në të kundërtën parashihet gjoba. Bashkësia Islame nuk po na raporton, theksoi ai.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – tha se komuna po i paguan mijetet financiare ndaj Bashkësisë Islame. Në këtë rast, komuna duhet ta "detyrojë" Bashkësinë Islame, në rastin tonë kompaninë, që mos ta varros asnjë qytetar pa e marrë lejen e varrimit në komunë. Ai pyeti se Bashkësia Islame përveç të vdekurve që i përkasin përkatësisë fetare islame, <a ua falë xhenazen> edhe përkatësive tjera fetare? Për këtë pyetje ai nuk mori përgjigje, kurse deklaroi se nëse nuk <ua falë xhenazen> përkatësive tjera fetare, a i merr paratë për këta persona të vdekur?

**Mehmet Selaci, drejtor i Drejtorisë për Administratë** – deklaroi se Bashkësia Islame për çdo muaj dërgon regjistrin për të vdekurit në Drejtorinë për Shërbime Publike. Prandaj, në këtë regjistër figurajnë emrat dhe mbiemrat e qytetarëve. Kështu që në bazë të kësaj dihet edhe përkatësia fetare.

**Shpëtim Zhegrovë, anëtar i KPF-së** – theksoi se po shihet qartë se informatat dhe dokumentacionin që e kam kërkuar për memorandumin me Bashkësinë Islame po fshehen. E

para, ky memorandum ka shkelje ligjore (i jashtëligjshëm) dhe e dyta është se buxheti i komunës po keqpërdoret në mënyrën më të keqe të mundshme, sepse unë kam menduar që pagesa për të vdekurit bëhet në bazë të gjendjes civile.

Zhegrova kërkoi regjistrin dhe faturat për të vdekurit nga data 1.1.2018 deri 5.12.2018 deri në seancën e kuvendit.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.*

4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktim të lokacionit për mbeturinat inerte.

Krezarta Krasniqi, anëtar e KPF-së – pyeti se a janë konsultuar banorët e fshatit Gllavatin lidhur me këtë çështje?

Sedat Rashica, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike – deklaroi se ka qenë kërkesë e vazhdueshme e drejtorit të shkollës "Liria" dhe të banorëve atje, për rreziqet e gropës së madhe që gjendet afër shkollës. Prandaj, duke e parë këtë rezik të nxënësve dhe fëmijë në bashkëpunim me banorët jemi pajtuar për këtë çështje.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë po frikësohet t'i nënshkruajë kopjet e planit. A kemi drejtor të drejtorisë apo këshilltarë të kryetarit? Ai kërkoi që për kuvend të na vjen me orto-foto, si dhe të kompletohet edhe kopjen e planit për Gllavatin pasi që mungon një gjë e tillë.

Fjolla Ujkani, anëtar e KPF-së – pyeti se a ka mundësi që këto kopje të planit të na sjellën në mënyrë tridimensionale (3D) apo dydimensionale (2D) për shkak se nuk po duken mirë. Ajo pyeti se a ka mbikëqyrje të mbeturinave? Për shkak se mbeturinat që nuk janë interte mund të përzihen me mbeturinat inerte. A mund të bëhet një marrëveshje në mes komunës dhe prodhuesit, për kompensim të mbetjeve inerte me një çmim më të vogël dhe ato mbetje të shiten dikund, ku me këtë do të përfitonë edhe komuna, por edhe prodhuesi.

Sedat Rashica, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike – lidhur me mbikëqyrjen e mbeturinave, Drejtoria për Inspektime duhet ta kryejë punën e saj lidhur me këtë çështje.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – tha se më herët ka qenë praktikë që në sallën e kuvendit prezantoheshin lokacionet në televizion dhe nuk kishte dilema se për cilin vend është fjalë. Prandaj, ai kërkoi që të vendoset televizioni në sallë dhe mos të kemi dilema.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që t'i bëhet një shkresë përcjellëse dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës kjo pikë e rendit të ditës.*

5. Shqyrtimi i Raportit për implementimin e planit për integritet për 2016-2018.

Haki Maloku, përgjegjës i sekretarisë – sqaroi se këtij plani ia kemi shtuar edhe një kolonë për realizim të objektivave dhe aktiviteteve. Ai tha se matja e realizimit të këtij plani është bërë në bazë të raporteve, të cilat janë marrë nga drejtoritë dhe zyrat, të cilat kanë qenë bartëse të aktivitetit.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.*

## **6. Shqyrtimi i Raportit vjetor 2017 i Ndërmarrjes regionale “Mitrovica”.**

**Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së** - tha se na është thënë shpeshherë se marrim më pak, kurse paguajmë më shumë. Në këtë raport e pash që edhe saturimi, por edhe inkasimi në raport me Mitrovicën ka një mospërpulje. Ai kërkoi që auditorët e brendshëm të komunës ta analizojnë këtë raport dhe të japid vlerësimin e tyre.

**Fjolla Ujkani, anëtarë e KPF-së** – deklaroi se duhet ta kemi parasysh se sa është numri i banorëve që janë të kyçur në rrjetin e ujësjellësit dhe sa është shuma që paguan komuna jonë. Po ashtu, ta dimë se sa banorë i ka Mitrovica dhe sa janë të kyçur në rrjetin e ujësjellësit dhe me këtë e dimë se cila komunë paguan më shumë. Ujkani pyeti se a është duke vazhduar shtrirja e ujësjellësit në komunën tonë? Ku qëndron problemi? Kjo për shkak, se ka pasur ngecje në këtë drejtim, ku më shumë se një vit nuk ka pasur lëvizje në këtë projekt.

**Sedat Rashica, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike** – sa i përket zgjerimit të rrjetit të ujësjellësit, komuna është duke e realizuar këtë projekt, ku për momentin është duke u kryer në fshatin Pestovë, dhe pritet të kyçen rrith 285 familje.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – deklaroi se përsaqësuesit e këtyre dy kompanive duhet të stohej në mbledhjen e kuvendit të komunës, në mënyrë që ne t'ua adresojmë kërkesat dhe shqetësimet tona. Haradinaj tha se bordet duhet të janë profesionale, e jo politike, si dhe të kenë kritere për përgjedhjen e anëtarëve të tyre. Mandej tha se tri komunat: Vushtrria, Mitrovica dhe Skënderaj i kanë performancë negative dhe ky fakt duhet t'i shqetësojë bordet dhe kompanitë e këtyre ndërmarrjeve. Prandaj, edhe ne si kuvend duhet të ndërmarrin diçka, sepse gjendja me ujë të pijes nuk është në nivelin e duhur. Ai theksoi se këto raporte të parashihen me plan të punës së kuvendit diku në shkurt ose mars 2019.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – tha se prodhimi i ujit dhe uji që dërgohet tek konsumatori janë dy gjëra të ndryshme. Në bazë të shifrave të prezantuara në këtë raport, del që një qytetar i Vushtrrisë që furnizohet nga fabrika në Balincë harxon në ditë më shumë se 409 litra ujë dhe kjo nuk ka logjikë. Derisa, në bazë të një mesatareje, një qytetar në vendet perëndimore harxon jo më shumë se 200 litra ujë në ditë. Menaxhmenti në fabrikë duhet ta bëjë një krahasim se sa harxon një familje 4-5 anëtarëshe. Në bazë të kësaj lehtë e kishim llogaritur se sa kemi humbje të ujit në rrjet, tha Klinaku. Konsideroj që kemi mbi 80% humbje të ujit, kurse pse ata në raport e kanë fshetur këtë, është çështje e tyre. Sa i përket shtrirjes së rrjetit të ujësjellësit, ai tha se në këto fshatra të Artakollit nuk ka shkuar rrjeti i ujësjellësit: Stroe, Beçuk, Zhilivodë, kurse kompania “Lux Development” e ka pasur për obligim që në 25 fshatra ta shtrijë rrjetin primar (kryesor). Lidhur me shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në fshatrat e Artakollit, Klinaku kërkoi informatë me shkrim se deri ku ka shkuar realizimi i këtij projekti.

**Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së** - tha se në takimin që kemi pasur me përsaqësues të Ministrisë për Zhvillim Ekonomik, na kanë premtuar se do të na përkrahin. Mirëpo, pas hulumtimit që kanë bërë, ministria na ka njoftuar se kompania “Lux Development” ka pasur

ngecje dhe se ministria ka marrëveshje me kompaninë në sjalë. Kemi kërkuar edhe nga Ministria e Mjedisit që të na përkrahur në këtë drejtim.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës. Por, kërkoi që njësia e auditimit të komunës ta analizojë këtë raport deri në mbledhjen e kuvendit dhe ta jep vlerësimin.*

## 7. Shqyrtimi i Raportit vjetor 2017 i Ndërmarrjes “Uniteti”.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – pyeti se me çfarë përqindje merr pjesë në aksione, Komuna e Vushtrrisë?

Sedat Rashica, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike – tha se komuna jonë merr pjesë me 28.6% të aksioneve.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – tha se komuna nuk ka pasur të drejtë të nënshkruaj memorandum mirëkuptimi me kompaninë “Uniteti”. Kryetari i komunës në seancë të kuvendit tha se KRPP-ja më ka kthyer përgjigje dhe ka thënë se kemi të drejtë me nënshkruar memorandum. Mirëpo, sipas përgjigjes që e ka dërguar KRPP-ja thuhet se: referoju tabelës, që sipas usaj tabele kërkohet që për të pasur të drejtë me nënshkruar memorandum, duhet të ketë mbi 51% të aksioneve. Prandaj, komuna ka bërë shkelje ligjore për këtë.

Ai përsëri kërkoi memorandumin në mes komunës dhe “Unitetit”, faturat dhe pagesat.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se është një raport i auditimit i tmerrshëm, i cili ka shumë të gjetura.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – theksoi se është problem për të gjetur diçka të mirë në këtë raport.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës. Por, kërkoi që njësia e auditimit të komunës ta analizojë këtë raport deri në mbledhjen e kuvendit dhe ta jep vlerësimin.*

## 8. Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë financiare për shërim të Bahrije Pllanës.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – tha se brenda mundësive ligjore dhe buxhetore duhet t'i ndihmojmë secilit qytetar, e posaçërisht edhe koleges sonë, Bahrijes, e cila e meriton të përkrahet. Mirë është që Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale të na njoftojnë përmjet që posedojnë në këtë kategori dhe pastaj në kuvend të marrim vendim se sa kemi mundësi t'i ndihmojmë.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – tha se jo vetëm kësaj here ta përkrahim me mjete financiare, por ta përcjellim edhe më tutje që ta përkrahim. Po ashtu, edhe Drejtoria për Arsim ta përkrah Bahrijen, sepse është punëtore e kësaj drejtorie.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – deklaroi se duhet t'i shikojmë të gjitha mundësitë ligjore, jo vetëm financiarisht, por edhe në forma tjera. Haradinaj tha se, Bahrija ka më shumë se një muaj që nuk vjen në shkollë, kurse ne si kolektiv jemi organizuar dhe po ia mbajmë orët e saj.

**Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – tha se duhet t'i analizojmë të gjitha mundësitë ligjore dhe të gjejmë përkrahje për Bahrijen.**

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – deklaroj se kuvendi i komunës e ka votuar rregulloren për subvencione, e cila parashesh që kryetari i komunës të ndajë mjete financiare deri në 1000€. Prandaj, duhet të shikohen mundësitë ligjore që ta përkrahim Bahrijen, tha Klinaku.**

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.*


9. Të ndryshme.

**Rrezarta Krasniqi, anëtare e KPF-së – se di a është problemi tek sekretaria e kuvendit që nuk e ka dërguar kërkesën time për emërim të një shkolle me emrin e profesor Hajzer Krasniqit tek qeveria komunale apo është problemi tek qeveria komunale që nuk më kanë kthyer përgjigje. Unë kërkoj përgjigje lidhur me këtë.**

**Bujar Klinaku, zyrtar nga sekretari – ia sqaroi anëtares së KPF-së dhe kuvendit se sekretaria e kuvendit e ka dërguar kërkesën e saj tek përfaqësuesit e qeverisë komunale. Prandaj, kërkesën në fjalë do t'u përejellim në e-mail, ku të njëjtën do t'u dërgojmë edhe kryetarit të komunës dhe drejtorit të Drejtorisë për Arsim.**

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.

Bujar Klinaku



Procesmbajtës

